Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0834

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Isa Hasani - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE)"KUQI FARMS SH.P.K.". lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores ne Komunen e Pejes"me nr. të prokurimit:"635-23-9027-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KOMUNA E PEJES, me datën, 23.01.2024, mori këtë:

Vendim

1.Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik, "KUQI FARMS SH.P.K."e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me, 25.10.2023, me numër: 834/23, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Trajtimi i qeneve endacak dhe menaxhimi i strehimores në Komunën e Pejës " me nr. të prokurimit: " 635-23-9027-2-1-1 ", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Komuna e Pejë.

2.Njoftimi mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues, i datës11.10.2023, dhe aktiviteti i prokurimit të prokurimit: " 635-23-9027-2-1-1., ANULOHET në tërësi.

3.Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ne të kundërtën, OSHP ka te drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4.Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak –

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 03.11.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandime.

Në mbështetje te Rregullore 01/2020 e Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit gjegjësisht nenit 13 Dorëzimi i Ankesave paragrafi 9 i nenit 13 kërkohet që "Pretendimet ankimore duhet të jenë te njëjta me ato të paraqitura për autoritetin kontraktues".

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues KUQI FARMS SH.P.K." dhe përgjigjet e ekspertit shqyrtues përmes raportit nr.834/2023, si në vijim:

Pretendimi ankimor Nr.1.Operatori Ekonomik ankues thotë se arsyeja e parë është qe Autoriteti Kontraktues-, vlerësimin e ofertave dhe rekomandimin që me kontrate qe të shpërblehet grupit te operatoreve ekonomik N.T.SH. VETERINA - PEJË; Haki Bytyçi B.I. e ka bere në kundërshtim të plote me nenin 59 LPP, pasi që oferta e GOE - N.T.SH. VETERINA - PEJË; Haki Bytyçi B.I. nga Peja është oferte e pa përgjegjshme.

Kërkesa 3 OE duhet te prezantoj Objektin (tipin) e strehimores se qeneve dhe ambulanten e specializuar për këto shërbime te jete brenda territorit te Komunës se Pejës minimum 15klm.

Dëshmia 3 O.E duhet te duhet te ketë ne pronësi te veten Objektin (tipin) e strehimores se qeneve dhe ambulanten brenda territorit te Pejës minimum 15 klm te dëshmuar me foto ose fleta poseduese , , Në rast se OE nuk posedon Objektin e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të Objektit . Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit.

OE, e ka një marrëveshje te prezantuar por jo sipas kërkesës se AK, ku decidivishte kërkohet te jete e Noterizuar të Noteri - GOE ka dështuar te plotësoj kërkesën e AK ne ketë pikë. Lidhur me pretendimin ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës ne dosjen e tenderit tek përveç tjerash ka kërkuar edhe kërkesat si ne vijim: Kërkesa sipas DT: Kërkesa 3 OE duhet te prezantoj Objektin (tipin) e strehimores se qeneve dhe ambulanten e specializuar për këto shërbime te jete brenda territorit te Komunës se Pejës minimum 15klm.Ndërsa për ta dëshmuar ketë kërkesë është kërkuar. Dëshmia e kërkuar sipas DT: Dëshmia 3 O.E duhet te duhet te ketë ne pronësi te veten Objektin (tipin) e strehimores se qeneve dhe ambulanten brenda territorit te Pejës minimum 15 klm te dëshmuar me foto ose fleta poseduese , , Në rast se OE nuk posedon Objektin e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të Objektit . Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit. Ne bazë te dëshmive te prezantuara ne sistem te prokurimit elektronik nga GOE te rekomanduar për kontrate për ketë projekt ka prezantuar një Deklarate nga Arbnore Nila.Ashtu siç shihet ne deklarate znj. Nila deklaron se ia jep ne shfrytëzim pronën bashkëshortit te saj z. Turhan Nila për projektin ne fjalë.Deklarata është e nënshkruar nga zonja ne fjale dhe e njëjta ka një vule te noterit.Ashtu siç e ka specifikuar Deklaratës ja ka bashkangjitur edhe fletën poseduese te datës 21.06.2023.

Ne baze te këtyre dëshmive te prezantuara nga ana e GOE te rekomanduar për kontrate shihet se i njëjti nuk ka ne pronësi te vetën Objektin (tipin) e strehimores se qeneve por për ta plotësuar ketë kërkesë GOE ne fjale e kanë dorëzuar një deklaratë se i epet ne shfrytëzim prona dhe objektit bashkëshortit si person fizik për ketë aktivitet te prokurimit. Siç shihet ne dokumentet e bashkangjitura GOE te rekomanduar për kontrate nuk e kanë dorëzuar marrëveshjen për ketë aktivitet ashtu siç kërkohet, marrëveshje te cilën është dashur ta nënshkruajnë te dy palët ne prezent te noterit.Ne baze te sqarimeve te specifikuar me larte eksperti shqyrtues mendon se AK gjate vlerësimit te këtij aktiviteti nuk ka respektuar kërkesat e specifikuara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate, AK ka vepruar ne kundërshtim me kërkesat qe vete i ka specifikuar, dhe ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi gjegjësisht ne kundërshtim me nenin 59.4 te LPP-se dhe ne kundërshtim me nenin 40 te Rregullores nr. 001/2022 për prokurimi publik, ne baze te nenit 40.13 specifikohet saktë se "AK do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit". Nga sqarimet e specifikuara me larët për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimore është i bazuar.

Pretendimi ankimor Nr. 2 Kërkesa 4 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Ekskavator Minimum 1 copë 2. Pikap Minimum 2 copë 3. Kafaz transportues Minimum 1 copë 4. Qafore, qante ushqimi dhe mjete kimike qe mund te përdoren për kafshe agresive Minimum nga një 1 copë. Dëshmia 4 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit. Pajisjet motorike të janë te regjistruara dhe kanë sigurim valid. Vërejtje Autoriteti Kontraktues mban të drejtën që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet. GOE ka dështuar te plotësoj kërkesën e AK ne ketë pikë.Nuk ka prezantuar Listë të mjeteve sipas kërkesës se AK-së.Nuk ka prezantuar fare : kafaz transportues Minimum 1 copë 4 Qafore, qante ushqimi dhe mjete kimike që mund te përdoren për kafshe agresive Minimum nga një 1 copë. Ka prezantuar marrëveshje për Ekskavator te Noterizuar.·

GEO nuk është i përgjegjshëm, nuk ka plotësuar kërkesat sipas kërkesës se AK nuk ka dëshmua pronësinë me (faturë, Dud) , ka paraqitur vetëm disa autenciteti i tyre nuk dihet.OE ka dështuar te dëshmoj . Lista e mjeteve duhet te dorëzohet e skanuar nga origjinale - e nënshkruar dhe e vulosur nga O.E. Sepse kur ka prezantuar Marrëveshjet për projektin i ka futur makinerinë ne marrëveshje por JO NE LISTE - ashtu siç kërkon AK , prandaj edhe ne ketë pike OE është i pa-përgjegjshëm. K - gjatë ekzaminimit te ofertave nuk ka menduar fare këto fakte sepse po te kishte analizuar me siguri se nuk do te rekomandonte një OE te pa-përgjegjshëm. Lidhur me pretendimin e tretë ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës ne dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përveç tjerash ka kërkuar edhe kërkesat si ne vijim: Kërkesa sipas DT: Kërkesa 4 Lista e mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve 1. Eskavator Minimum 1 copë 2. Pikap Minimum 2 copë 3. Kafaz transportues Minimum 1 copë 4. Qafore, qante ushqimi dhe mjete kimike qe mund te përdoren per kafshe agresive Minimum nga nje 1 copë. Dëshmia e kërkuar sipas DT: Dëshmia 4 Lista e mjeteve duhet të dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit, ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmojë me një dokument për pronësinë e tyre (faturë, DUD etj). Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon ndonjë nga pajisjet e kërkuara, duhet te ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet te jetë në emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar – e nënshkruar ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit. pajisjet motorike të janë te regjistruara dhe kanë sigurim valid. Vërejtje Autoriteti Kontraktues mban të drejtën

që të bëjë verifikimin e pajisjeve të ofruara. Në rast të mospërputhjes së të dhënave, OE do të eliminohet. Ne bazë të dëshmive te prezantuara GOE te rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar një listë te mjeteve te punës ne te cilën është kërkuar qe të specifikohen mjetet e punës qe janë kërkuar. Për mjetin e punës ekskavator kanë prezantuar kontratën e qirasë ne mes te Ved - Ing shpk si qiradhënës dhe z. Turhan Nila (si person fizik) si qiramarrës, si dhe faturën e blerjes se ekskavatorit .GOE te rekomanduar për kontratë kanë bashkangjitur 2 libreza për Pikap që janë kërkuar sipas përshkrimit.1. Automjeti VOLKSWAGEN-VW CADY me targa 03-687-EQ ne emër te z. Turhan Nila dhe2. Automjeti OPEL COMBO me targa 03-102-CR ne emër te N.T.Sh VETERINA. Në baze te dokumentacionit ne sistemin e prokurimit për mjetet e punës si: Kafaz transportues Minimum 1 copë, Qafore, qante ushqimi dhe mjete kimike qe mund te përdoren për kafshë agresive Minimum nga një 1 copë nga GOE te rekomanduar per kontratë janë dorëzuar disa fotografi por nuk kanë dorëzuar ndonjë dëshmi ashtu siç kërkohet se te njëjtat i posedojnë (fature, DUD apo diçka tjetër).Nga dokumentet qe janë te ngarkuara ne sistemin e prokurimit elektronik nuk ka dëshmi se AK gjate vlerësimit te këtij aktiviteti ka kërkuar informacione shtesë sa i përket kësaj kërkese për mjetet e punës qe janë kërkuar. Në baze te sqarimeve te specifikuara me larët për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Për mendimin e eksperti shqyrtues gjate vlerësimit te këtij aktiviteti Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar nenin 59 dhe 69 LPP-se, nenin 40 te RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, AK ka vepruar ne kundërshtim me kërkesat te cilat vet i ka vendosur ne njoftimin për kontrate dhe ne dosjen e tenderit. Gjatë vlerësimit te ofertave nga ana e Autoritetit Kontraktues duhet te respektohen kërkesat e përzgjedhjes te cilat janë te vendosura ne dosjen e tenderit te cilat janë te specifikuar nga ana e Autoritetit kontraktues si dhe te respektohen ne përpikëri kriteret e dhënies. Ne mbështetje të Ligjit për prokurimi publik dhe legjislacionit sekondar Autoriteti Kontraktues vlerësimin e ofertave duhet ta bej ne përputhje me dispozitat ligjore në mënyrë qe të gjithë OE pjesëmarrës te trajtohen ne mënyrë te barabartë ashtu siç kërkohet me nenin 7 te LPP-se.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike ne e-prokurim, rrjedhjen dhe procedurën e prokurimit me këtë aktivitet te prokurimit është ne përgjegjësi dhe ne diskrecion te Autoriteti Kontraktues qe vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave te behën ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se si dhe legjislacionit sekondar te prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik nr.83/20, e datës, 03.03.2020, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin

e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë konstatuar si të *bazuara*

Sipas të thënave si më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues *OE* "KUQI FARMS SH.P.K." Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues mbështet në plotësi raportin e ekspertit shqyrtues, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish. Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga AK, por që vlerësohet se me kthimin e këtij aktiviteti të prokurimit në Rivlerësim AK do bëjë Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve konform Nenit 59 të LPP-së, si dhe ti trajtoj të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, si dhe të veproj konform rekomandimeve te lartcekura në raportin e ekspertizës si dhe të veproj në tërësi me dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje lidhur me pohimet ankimore. Prandaj Paneli shqyrtues mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues dhe vendos që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit të veproj konform nenit 59 të LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP-së dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, duke cituar: "Të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **KUQI FARMS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: